



Funded by  
the European Union

## UDHËZIME PËR APLIKANTËT

### THIRRJE PËR PROPOZIME

**Promovimi i të drejtave të punës, raportimi i shkeljeve edhe angazhimi në dialogun social me autoritetet publike në Kosovë**

**Autoriteti Kontraktues:** Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC

**Projekt i financuar nga:** Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

**Titulli i projektit:** "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cënueshme në tregun e punës"

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:

21 nëntor 2022, ora 16:00





Tabela e përmbajtjes:

1. Përshkrimi i sfondit të Aktivitetit	3
1.1 Objektivat dhe Prioritetet e Thirrjes për Propozime	5
2. Kualifikueshmëria e aplikantëve	9
2.1 Aplikanti i OSHC-së duhet:	9
2.2 Aplikanti i sindikatave duhet:	9
2.3 Grupet ose subjektet e regjistruara duhet:	10
2.4 Kriteret e përjashtimit	10
3. Veprimet e kualifikueshme në kuadër të fushëveprimit të projektit	11
3.1 Madhësia dhe kohëzgjatja e nën-granteve	11
3.2 Fushëveprimi i Aktiviteteve	11
3.3 Aktivitetet e kualifikueshme:	11
3.4 Aktivitetet jo të kualifikueshme:	12
4. Pranueshmëria e kostove: Kostot që mund të merren parasysht për grantin	12
5. Procedurat e Aplikimit	14
6. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve	14
7. Njoftimi i Autoritetit Kontraktues	15
7.1 Përmbajtja e vendimit	15
7.2 Plani kohor indikativ	16
7.3 Sesionet informuese	16



## 1. Përshkrimi i sfondit të Aktivitetit

Në vitet e fundit, Kosova është prekur nga kriza e pandemisë COVID-19, e cila ka ngadalësuar zbatimin e ligjit të punës dhe për shkak të masave të bllokimit e ka bërë të pamundur për inspektoratin e punës të monitorojë kushtet e punës së punëtorëve. Një bllokim i tillë ka krijuar hapësirë që kompanitë të mos respektojnë të gjitha masat që kanë qenë në fuqi, duke rrezikuar edhe më shumë mirëqenien e punëtorëve. Edhe pse korniza ligjore që rregullon të drejtat e punës në Kosovë është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi në mbrojtjen e këtyre dispozitave mbetet i dobët. Ligji i punës Nr. 03/L –212 është miratuar në vitin 2010, dhe rregullon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në sektorin privat dhe publik. Ligji i Punës përbëhet prej gjithsej 100 neneve që, mes tjerash, mbulojnë termat dhe kushtet e punësimit, diskriminimin, të drejtat e pushimit të lehonisë dhe familjes, ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe procedurat gjyqësore. Ligji ndalon rreptësisht diskriminimin në baza gjinore, racore, fetare, të moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit politik, identitetit kombëtar dhe gjuhës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës, të rregulluara me këtë ligj si dhe me dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit. Ligji i Punës specifikon më tej se puna e detyruar, puna e fëmijëve, pabarazia në punë dhe puna joformale janë të ndaluara.

Për më tepër, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës, Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është miratuar në vitin 2013 dhe reforma që është duke u zhvilluar po ndryshon Ligjin e Punës dhe Ligjin për Inspektoratin e Punës. Por megjithatë, zbatimi praktik i Ligjit të Punës mbetet sfidë për punëdhënësit e sektorit privat dhe institucionet publike në Kosovë. Të drejtat e punëtorëve i nënshtrohen shkeljeve të rënda në të dy sektorët, duke shkelur kështu standardet dhe marrëveshjet e rëndësishme ndërkombëtare të punës. Megjithatë, kushtet e punës në sektorin privat janë veçanërisht sfiduese dhe dukshëm më të këqija se sa ato në sektorin publik.

Raportet ndërkombëtare kanë dëshmuar më tej për zbatimin e pamjaftueshëm të Ligjit të Punës në Kosovë. Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2021 *ngre një sërë shqetësimesh në lidhje me politikën sociale dhe punësimin*<sup>1</sup>. Raportet theksojnë se Kosova është në fazën e hershme të përgatitjes në fushën e politikave sociale dhe punësimin. Gjatë periudhës raportuese ka pasur progres të kufizuar, veçanërisht në zbatimin e rregulloreve të shëndetit dhe sigurisë. Shkalla e incidenteve fatale mbetet jashtëzakonisht e lartë, veçanërisht në sektorin e ndërtimitarisë.

<sup>1</sup> Raporti i Kosovës 2021 i Komisionit Evropian.

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)



Në lidhje me përmirësimin e kushteve të punës, të drejtave të punëtorëve dhe garantimit të standardeve minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka prezantuar objektivat strategjike përmes Strategjisë Sektoriale 2018-2022<sup>2</sup> që synon të forcojë kapacitetet e Inspektoratit të Punës, si i vetmi institucion ekzekutiv për monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit, për të garantuar standardet minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë. Por pavarësisht progresit të shënuar, ka ende punë për t'u bërë në mënyrë që të krijohen kushtet për zbatim. Shumica e punëtorëve në Kosovë nuk mbulohej nga sigurimet shëndetësore dhe nuk ka sigurim kundër lëndimeve dhe sëmundjeve të ndërlidhura të pësuar gjatë kryerjes së punës. Një pjesë e vogël e fuqisë punëtore mbulohet nga sigurimet shëndetësore private, përqindja e të cilëve mbetet e ultë<sup>3</sup>.

Edhe pse Kosova ka intensifikuar përpjekjet për të adresuar diskriminimin ndaj grave, duke miratuar legjislacionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zbatimi praktik mbetet i ulët dhe gratë vazhdojnë të jenë në disavantazh në tregun e punës. Ndërsa, duke krahasuar gratë dhe burrat në punësim dhe politika sociale, diskriminimi në baza gjinore ka vazhduar të jetë e përhapur në rekrutim, avancim, pagë dhe kohëzgjatje të kontratës. Në vitin 2020, shkalla e punësimit për popullsinë 20-64 vjeç ishte 16% për gratë dhe 48.8% për burrat, duke rezultuar në një hendek shumë të lartë të punësimit gjinor prej 32.8 pikë përqindjeje<sup>4</sup>. Pjesëmarrja e të rinjve në tregun e punës tregon se shkalla alarmante e papunësisë së të rinjve (49.1% për grupmoshën 15-24 vjeç) ka vazhduar, duke nënkuptuar probleme strukturore, si puna e padeklaruar dhe mospërputhje midis rezultateve të arsimit dhe nevojave të tregut të punës<sup>5</sup>. Personat me nevoja të veçanta kanë pengesa për punësim, dhe e njëjta gjë vlen edhe për pjesëtarët e komuniteteve të tjera, veçanërisht pjesëtarët e komuniteteve Rom, Egjiptian dhe Ashkali, të cilët i nënshtrohen papunësisë së lartë dhe punës joformale<sup>6</sup>.

Duke marrë parasysh situatën e përgjithshme me të drejtat e punës së kategorive të ndjeshme, ATRC dhe BIRN Kosova janë bashkuar me qëllim të forcimit të pajtueshmërisë me ligjet e punës.

<sup>2</sup> Strategjia Sektoriale 2018-2022. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

<https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/strategjia-sektoriale-2018-2022/>

<sup>3</sup> Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale 2021. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. <https://www.esap.online/docs/151/performance-of-western-balkan-economies-regarding-the-european-pillar-of-social-rights-2021-review-on-kosovo>

<sup>4</sup> Raporti i Kosovës 2021 i Komisionit Evropian.

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)

<sup>5</sup> Raporti i Kosovës 2021 i Komisionit Evropian.

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)

<sup>6</sup> Performanca e Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në lidhje me Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale 2021. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. <https://www.esap.online/docs/151/performance-of-western-balkan-economies-regarding-the-european-pillar-of-social-rights-2021-review-on-kosovo>



Funded by  
the European Union

Prandaj, përmes monitorimit dhe raportimit të drejtpërdrejtë të rasteve të keqpërdorimit të të drejtave të punës, duke forcuar kapacitetet e bartësve të detyrës, gazetarëve dhe OSHC-ve për të punuar në të drejtat e punës dhe ndërgjegjësimin e publikut për Ligjin e Punës. Projekti "Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cenushme në tregun e punës" synon të përmirësojë kushtet e punës për kategoritë e ndjeshme të punonjësve, veçanërisht brenda sektorit privat, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës për gratë dhe burrat, përmes promovimit të dialogut social midis punëtorëve dhe bartësve të detyrës.

Nëpërmjet këtij projekti, skema e nën-granteve do të japë deri në 20 grante. Thirrja për Propozime është komponenti kryesor i projektit, i cili synon të ofrojë mundësi të reja për sindikatat, OSHC-të lokale, shoqatat e avokatëve dhe grupet (subjektet) tjera të regjistruara që punojnë dhe veprojnë në Kosovë, në mënyrë që ata të mund të trajtojnë çështjet që lidhen me të drejtat e punës dhe dialogun social. Skema e dhënë synon të promovojë të drejtat e punës, të zhvillojë kapacitetet për raportimin e shkeljeve të të drejtave të punës, të zhvillojë hulumtime mbi politikën, legjislativonin dhe temat e lidhura me to, si dhe për angazhimin në dialogun social me autoritetet publike.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, përfituesit e nën-granteve do të kenë mundësinë të forcojnë të drejtat e punës së kategorive të ndjeshme, zbatimin e ligjit të punës dhe përmirësimin e kushteve të punës, duke trajnuar fuqinë punëtore, duke prodhuar raporte cilësore dhe analitike për çështjet e ligjit të punës, si dhe duke mbështetur punonjësit me informacione mbi kushtet e punës.

### 1.1 Objektivat dhe Prioritetet e Thirrjes për Propozime

Objektivi i përgjithshëm i Thirrjes për Propozime është të *promovojë të drejtat e punës dhe punën e denjë përmes forcimit të ndërgjegjësimin për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat, mbrojtjen nga diskriminimi në vendin e punës, si dhe të përmirësojë dialogun social me autoritetet publike në Kosovë.*

Objektivi specifik i Thirrjes për Propozime është të *kontribuojë në avancimin dhe zbatimin e ligjit të punës dhe ligjeve të tjera që lidhen me fushën e të drejtave të punës.* Fushat tematike të kësaj Kjo Thirrjeje për Propozime përmbajnë 2 LLOTE, siç përshkruhet më poshtë:

**LLOTI I:** Hulumtim dhe forcimi i dialogut social gjithëpërfshirës për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e punës.

**LLOTI II:** Rritja e ndërgjegjësimin për të drejtat e punës dhe raportimi i shkeljeve të të drejtave të punës.

ATRC planifikon të japë deri në **20 grante**, prej të cilave 10 grante do të jepen për LLOTIN I dhe 10 grante do të jepen për LLOTIN II.





Thirrja për Propozime do të shqyrtojë gjithashtu integrimin e çështjeve ndër-sektoriale në nivel projekti. Gjatë zhvillimit të projektit për të adresuar cilindo nga objektivat specifike të Thirrjes, çështjet ndër-sektoriale duhet të përfshihen në mënyrën si në vijim:

- a) Barazia gjinore, promovimi i mundësive të barabarta të tregut të punës dhe trajtimi në punë<sup>7</sup>.
- b) Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punës së minoriteteve etnike<sup>8</sup>.
- c) Sigurimi social dhe mbrojtja sociale e punëtorëve<sup>9</sup>.
- d) Integrimi i personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore në tregun e punës<sup>10</sup>.
- e) Informimi dhe konsultimi i punëtorëve<sup>11</sup>.
- f) Lufta ndaj përjashtimit social<sup>12</sup>.
- g) Parandalimi dhe ndalimi i punës së detyruar të fëmijëve<sup>13</sup>.

---

<sup>7</sup> Koncepti që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë kanë kushte, trajtim dhe mundësi të barabarta për të realizuar potencialin e tyre të plotë, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin dhe për të kontribuar në (dhe për të përfituar prej) zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe politik. Barazia gjinore, fjalorth i termave dhe koncepteve. UNICEF.

<https://www.unicef.org/rosa/media/1761/file/Gender%20glossary%20of%20terms%20and%20concepts%20.pdf>

<sup>8</sup> Shtylla themelore e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja ligjore e pakicave janë parimet e mos-diskriminimit dhe barazisë, të cilat përbëjnë bazën e të gjitha traktateve thelbësore të të drejtave të njeriut. Ato zbatohen për të gjithë në lidhje me të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ndalojnë diskriminimin në bazë të një liste jo shteruese të kategorive si raca, ngjyra, feja, gjuha, kombësia dhe etnia ose prejardhja e punës. Në lidhje me pakicat dhe të drejtat e njeriut. Kombet e Bashkuara.

<https://www.ohchr.org/en/minorities/about-minorities-and-human-rights>

<sup>9</sup> Mbrojtja sociale ka të bëjë me sigurinë e njerëzve dhe familjeve përballë dobësive dhe situatave të paparashikuara, ajo është të kenë qasje në kujdesin shëndetësor dhe ka të bëjë me punën në siguri. Mbrojtja Sociale. Zyra Ndërkombëtare e Punës.

<https://www.ilo.org/public/english/protection/download/lifecycl/lifecycle.pdf>

<sup>10</sup> Zbatimi i mundësive të barabarta duhet të sigurohet në projekt për të nxitur integrimin e personave të prekur nga aftësia e kufizuar dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e projektit (p.sh. qasja në ndërtesat dhe vendet e projektit) dhe në proceset e vendimmarrjes në përputhje me aktivitetet e projektit dhe rezultatet e pritura.

<sup>11</sup> Marrëveshjet për të informuar dhe konsultuar nënkuptojnë se ekziston një komunikim i vazhdueshëm midis punëdhënësit tuaj dhe punonjësve të tyre. Kjo duhet të përfshijë çdo zhvillim të rëndësishëm që mund të prekë njerëzit që punojnë për organizatën, informacionin dhe konsultimin e punonjësve.

<https://www.nidirect.gov.uk/articles/information-and-consultation-employees#toc-0>

<sup>12</sup> Përjashtimi lidhet me pakënaqësinë ose shqetësimin që ndjejnë individët që përballen me situata në të cilat ata nuk mund të arrijnë objektivat e tyre për veten ose për të dashurit e tyre. Nga ky këndvështrim, përjashtimi tenton të ketë një përmbajtje të caktuar subjektive të bazuar në fakte materiale. Duhet të kujtojmë gjithashtu se përjashtimi nga disa moda, zakone dhe ide dominuese mund të ketë një anë pozitive për disa individë, grupe ose komunitete, duke përforcuar kështu kohezionin e tyre të brendshëm. Në raste të tjera, përjashtimi vullnetar mund të jetë një parakusht për nxitjen e krijimtarsisë artistike ose intelektuale, ose për një jetë më filozofike ose fetare reflektimi, koncepte dhe strategji për të luftuar përjashtimin social. Zyra Ndërkombëtare e Punës-STEP.

<https://www.ilo.org/public/english/protection/socsec/step/download/96p1.pdf>

<sup>13</sup> Puna e fëmijëve është një shkëlqje e të drejtave themelore të njeriut dhe është treguar se pengon zhvillimin e fëmijëve, duke çuar potencialisht në dëmtime fizike ose psikologjike gjatë gjithë jetës. Provat tregojnë për një lidhje të fortë midis varfërisë së familjes dhe



h) Standardet demokratike, praktikat anti-diskriminuese dhe qeverisja e mirë<sup>14</sup>.

Numri i Llotit	Objektiva	Intervenimet e sugjeruara:
LLOTI I: Hulumtimi dhe forcimi i dialogut social gjithëpërfshirës	<p>1. Publikimi i raporteve të shkruara për të drejtat e punës dhe çështjet e ndërlidhura</p> <p>2. Promovimi i të gjitha llojeve të dialogut social</p> <p>3. Rritja e mbulueshmërisë dhe efektivitetit të mbrojtjes sociale</p> <p>4. Forcimi i trepartizmit dhe dialogut social</p>	<p>-Analiza dhe hulumtimi i politikave të punës, analizave të tregut të punës, mbrojtjes sociale, tatimeve apo politikave të tjera ekonomike.</p> <p>-Analiza dhe hulumtime mbi nivelin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të punës</p> <p>-Analiza e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, përfshirja e grupeve të cenueshme në tregun e punës.</p> <p>-Analiza e shkathtësive të punonjësve, analiza mbi organizimet e dialogut social dhe vlerësimet e nevojave.</p> <p>-Analiza dhe hulumtimi i situatës së punësimit para dhe pas pandemisë COVID-19 për grupet e marginalizuara.</p> <p>-Ngritja e kapaciteteve dhe trajnim.</p>

punës së fëmijëve, dhe puna e fëmijëve e përjetëson varfërinë ndër breza duke i mbajtur fëmijët e të varfërve jashtë shkollës dhe duke kufizuar perspektivat e tyre për lëvizshmëri sociale në rritje. Standardet Ndërkombëtare të Punës për Punën e Fëmijëve. ILO.

<https://www.ilo.org/global/standards/subjects-covered-by-international-labour-standards/child-labour/lang--en/index.htm>

<sup>14</sup> Demokracia mishëron qeverisjen e përgjegjshme dhe të përgjegjshme, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, pjesëmarrjen qytetare dhe transferimin paqësor të pushtetit përmes proceseve zgjedhore. Secila prej tyre mbështet një shoqëri paqësore dhe të qëndrueshme, Demokraci dhe Qeverisje. Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara. <https://www.usip.org/issue-areas/democracy-governance>



		<p>-Bashkëpunimi midis inspektoratit të punës dhe institucioneve të tjera relevante, etj.</p> <p>-Rritja e ndërgjegjësimit dhe mbështetja e punonjësve dhe punëdhënësve për dialogun social.</p>
LLOTI II: Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e punës dhe raportimi i shkeljeve të të drejtave të punës	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Promovimi i të drejtave të punës dhe ligjit të punës në mesin e kategorive më të ndjeshme, veçanërisht në sektorin privat</li> <li>2. Sigurimi i njohurive adekuate për raportimin e shkeljeve të të drejtave të punës</li> <li>3. Forcimi dhe promovimi i dialogut social</li> <li>4. Mbështetja e qasjes së barabartë në tregun e punës për grupet e marginalizuara në sektorin publik</li> <li>5. Garantimi i sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës</li> </ol>	<p>-Fushata avokuese përmes aktiviteteve të ndryshme që mund të përfshijnë konferenca, tryeza të rrumbullakëta për qëllime edukative, ndërgjegjësuese dhe avokuese.</p> <p>-Angazhimi i palëve të interesit të politikave nga institucionet qendrore dhe lokale rreth çështjeve të të drejtave të punës.</p> <p>-Barazia gjinore në tregun e punës.</p> <p>-Akademia dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës, shoqëria civile.</p> <p>-Aktivitetet e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve.</p> <p>-Rritja e ndërgjegjësimit për ligjin e punës.</p> <p>-Rritja e ndërgjegjësimit për detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ligji i punës, etj.</p>





## 2. Kualifikueshmëria e aplikantëve

Në mënyrë që të kualifikoheni për të marrë pjesë në këtë Thirrje për Propozime, duhet të plotësohen disa kritere. Siç u përmend më lart, nën-grantet parashihen që t'u jepen sindikatave, OSHC-ve lokale, shoqatave të avokatëve, grupeve të gazetarëve, asociacioneve të mediave dhe grupeve (subjekteve) ose bizneseve tjera të regjistruara, të cilat i plotësojnë kriteret e përshkruara si në vijim:

### 2.1 Aplikanti i OSHC-së duhet:

- të jetë organizatë jofitimprurëse;
- të jetë subjekt juridik i regjistruar në kuadër të autoriteteve të Kosovës së paku gjashtë muaj para se të publikohet kjo Thirrje;
- të sigurojë dokumentet e regjistrimit të organizatës (certifikatën e regjistrimit, certifikatën e numrit fiskal) dhe vërtetimin se i ka kryer të gjitha detyrimet ndaj shtetit, duke përfshirë regjistrimin pranë Administratës Tatimore, si dhe informacionet e llogarisë bankare;
- pasqyrat financiare ose raportet e auditimit të dy viteve të fundit (nëse është e aplikueshme);
- kapacitetet dhe profilin e organizatës, duke përfshirë, por pa u kufizuar: kapacitetet e burimeve njerëzore, projektet e kaluara dhe aktuale në dy vitet e fundit (burimi i financimit, afati kohor, partneritetet, objektivat).

### 2.2 Aplikanti i sindikatave duhet:

- të jetë subjekt i pavarur, që përfaqëson dhe mbron të drejtat dhe interesat juridike të anëtarëve të tij;
- të jetë subjekt juridik i regjistruar në kuadër të autoriteteve të Kosovës së paku gjashtë muaj para se të publikohet kjo Thirrje;
- të sigurojë dokumentet e regjistrimit të organizatës (certifikatën e regjistrimit, certifikatën e numrit fiskal) dhe vërtetimin se i ka kryer të gjitha detyrimet ndaj shtetit, përfshirë regjistrimin pranë Administratës Tatimore, si dhe informacionet e llogarisë bankare;
- pasqyrat financiare ose raportet e auditimit të dy viteve të fundit (nëse është e aplikueshme);
- kapacitetet dhe profilin e Sindikatës, duke përfshirë, por pa u kufizuar: kapacitetet e burimeve njerëzore, projektet e kaluara dhe aktuale në dy vitet e fundit (burimi i financimit, afati kohor, partneritetet, objektivat).



### 2.3 Grupet ose subjektet e regjistruara duhet:

- të jenë subjekte juridike të regjistruara në kuadër të autoriteteve të Kosovës së paku gjashtë muaj përpara se të publikohet kjo Thirrje;
- të jenë biznes i regjistruar që prodhon/publikon analiza juridike ose përmbajtje mediatike/punë gazetareske.
- të jenë në gjendje të sigurojë dokumentet e regjistrimit të organizatës/medias (certifikata e regjistrimit, certifikata e numrit fiskal, dokumenti i regjistrimit të biznesit) dhe vërtetimin se i kanë kryer të gjitha detyrimet ndaj shtetit, duke përfshirë regjistrimin pranë Administratës Tatimore, informacionet e llogarisë bankare, si dhe përvojën e mëparshme në implementimin e projekteve të lidhura me analiza juridike, punën gazetareske të propozuar (mostra/shembuj të analizave juridike, storje gazetareske të prodhuara/publikuara, duke përfshirë të dhënat aktuale të shtrirjes/të dhënat e shikueshmërisë, nëse është e aplikueshme).

Nëse aplikanti përzgjidhet për financim, kërkohen edhe parashtrimet e mëposhtme:

- deklarata e lëshuar nga autoritetet përkatëse, që vërteton se aplikanti dhe përfaqësuesi i tij nuk iu kanë nënshtruar ndonjë aktgjykimi që ka fuqinë *res juridicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale, pastrim parash ose ndonjë veprimtari tjetër të paligjshme;
- Të dhënat bankare.

### 2.4 Kriteret e përjashtimit

Aplikantët e mundshëm nuk mund të marrin pjesë në këtë Thirrje për Propozime, ose të fitojnë grante, nëse ndodhen në ndonjë prej situatave të mëposhtme:

- Janë të falimentuar ose punët e tyre administrohen nga gjykatat, kanë lidhur marrëveshje me kreditorët, kanë pezulluar aktivitetet e biznesit. Nuk janë në pajtueshmëri me detyrimet e tyre lidhur me pagimin e ndonjë tatimi, në përputhje me dispozitat ligjore të palës kontraktuese, të cilat janë të përcaktuara në marrëveshje;
- Ata, ose personat që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrëse ose kontrollit mbi ta, iu kanë nënshtruar ndonjë aktgjykimi që ka fuqinë *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale, pastrim parash ose ndonjë veprimtari tjetër të paligjshme;
- Veprimet e tyre të propozuara nuk janë mbështetur deri më tani nga Bashkimi Evropian, në mënyrë që të mos dyfishohen financimet nga Bashkimi Evropian për të njëjtat shpenzime;
- Janë të lidhur drejtpërdrejt me fitimin tregtar;
- Janë të përfshirë drejtpërdrejt në fushata politike.



Funded by  
the European Union

### 3. Veprimet e kualifikueshme në kuadër të fushëveprimit të projektit

Kjo pjesë ofron informacione mbi kohëzgjatjen, shumën dhe fushëveprimin e projekteve që do të financohen në kuadër të kësaj skeme të nën-granteve, dhe aktivitetet e kualifikueshme për të cilat aplikantët e mundshëm mund të kërkojnë mbështetje financiare në kuadër të kësaj Thirrje për Propozime.

#### 3.1 Madhësia dhe kohëzgjatja e nën-granteve

Lloti I: Shuma maksimale prej EUR **5,000** – Kohëzgjatja: Deri në gjashtë (6) muaj

Lloti II: Shuma maksimale prej EUR **10,000** - Kohëzgjatja: Deri në dhjetë (10) muaj

Afati kohor për implementimin e projekteve të mbështetura është nga data **janar 2023 deri më tetor 2023**.

#### 3.2 Fushëveprimi i Aktiviteteve

Të gjitha aktivitetet që do të zbatohen brenda fushëveprimit të programit të nën-granteve duhet të zbatohen në Kosovë; ato mund të përqendrohen në një komunë, një rajon ose të mbulojnë tërë territorin e Kosovës.

#### 3.3 Aktivitetet e kualifikueshme:

- Organizimi i fushatave avokuese, duke përfshirë konferencat, tryezat e rrumbullakëta për qëllime edukative, fushatat ndërgjegjësuëse dhe avokuese, angazhimi i palëve të interesuara të politikave nga institucionet qendrore dhe lokale rreth çështjeve të të drejtave të punës, barazia gjinore në tregun e punës, përgatitja e të rinjve për tregun e punës, shoqëria civile, dialogu social i sindikatave, komuniteti i biznesit, mediat, etj.;
- Projektimi dhe zhvillimi i fushatave të mediave sociale që shënjestrojnë çështjet që lidhen me temën thelbësore të të drejtave të punës të kategorive të ndjeshme që duhet të mbështeten;
- Aktivitetet e edukimit qytetar që synojnë ngritjen e çështjeve të të drejtave të punës dhe temave të tjera të lidhura me të, që shënjestrojnë kryesisht nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët e universiteteve;
- Publikimi i materialeve edukative dhe promovuese në forma të ndryshme mediatike;
- Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për punëmarrësit apo punëdhënësit për zbatimin e Ligjit të Punës;
- Aktivitetet që forcojnë dhe përmirësojnë dialogun social ndërmjet punonjësve dhe





Funded by  
the European Union

- autoriteteve publike;
- Mbështetja e kushteve të të drejtave të punës dhe pagave të dinjitetshme;
- Aktivitetet për të luftuar punën joformale të kategorive të ndjeshme;
- Raportet kërkimore mbi të drejtat e punës, dhe çështjet tjera të ndërlidhura, trajtimin e problemeve dhe ofrimin e rekomandimeve;
- Mbështetja e prodhimit të përmbajtjes së re përmes raportimit hetimor dhe/ose analizës së thellë të të drejtave të punës.

### 3.4 Aktivitetet jo të kualifikueshme:

- Aktivitetet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca, kongrese;
- Aktivitetet e ndërmarra para nënshkrimit të kontratës;
- Aktivitetet që synojnë aktivitetet fitimprurëse;
- Aktivitetet që janë të lidhura drejtpërdrejt me ose mbështetëse të partive politike.

### 4. Pranueshmëria e kostove: Kostot që mund të merren parasysht për grantin

Ne inkurajojmë të gjitha sindikatat, OSHC-të, shoqatat e avokatëve dhe subjektet tjera të regjistruara që të propozojnë buxhete realiste dhe me kosto efektive, në përputhje me çmimet e tregut. Vini re që kostot e pranueshme duhet të bazohen në kostot reale të bazuara në dokumentet mbështetëse.

Rekomandimet për dhënien e një granti i nënshtrohen gjithmonë kushtit që procesi i kontrollit, që i paraprin nënshkrimit të kontratës, të mos zbulojë ndonjë problem që kërkon ndryshime në buxhet (për shembull gabime aritmetike, pasaktësi ose kosto joreale, si dhe kosto të tjera të papërshtatshme). Kontrollat mund të ngritin kërkesat për sqarime dhe të bëjnë që Autoriteti Kontraktues të vendosë modifikime ose reduktime për të adresuar gabimet ose pasaktësitë e tilla. Shuma e grantit, për shkak të këtyre korrigjimeve, nuk mund të rritet. Prandaj është në interesin e aplikantit të sigurojë një buxhet realist dhe me kosto efektive.

**Kostot/kostot e kualifikueshme që ne mund të mbështesim janë kostot aktuale të bëra nga Përfituesi(-t), të cilat plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:**

- a) ndodhin gjatë implementimit të Aktivitetit, siç specifikohet në pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3;
- b) janë të paraqitura në buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar për Aktivitetin;
- c) janë të justifikuara mirë për implementimin e Aktivitetit;
- d) janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, veçanërisht duke u regjistruar në regjistrat e kontabilitetit të Përfituesit, si dhe të përcaktuara sipas standardeve të kontabilitetit dhe





- praktikave të zakonshme të kontabilitetit të kostos të zbatueshme për Përfituesin(-it);
- e) janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe social në fuqi;
  - f) janë të arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, veçanërisht në lidhje me ekonominë dhe efikasitetin.

### **Llojet e kostove të kualifikueshme/Llojet e shpenzimeve që ne mund të mbështesim:**

- a) kostot e personelit të caktuar në Aktivitet, duke përfshirë koston e personelit që kryen detyra financiare dhe administrative në lidhje me Aktivitetin, që korrespondon me pagat aktuale bruto, duke përfshirë tarifën e sigurimeve sociale dhe kostot tjera të lidhura me kompensimin; pagat dhe kostot nuk duhet të kalojnë ato që zakonisht përballohen nga Përfituesi(-t), përveç nëse justifikohet duke treguar se është thelbësore për kryerjen e Aktivitetit;
- b) shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës për personelin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në Aktivitet, me kusht që ato të mos kalojnë ato që zakonisht përballohen nga Përfituesi(-t) sipas rregullave dhe rregulloreve të tij, ose tarifën e publikuar nga Komisioni Evropian gjatë kohës së këtij misioni nëse rimbursohet në bazë të opsioneve të thjeshtuara të kostos;
- c) kostot e materialeve harxhuese;
- d) kostot e tarifave bankare;
- e) kostot e shkaktuara nga kontratat e dhëna nga Përfituesi(-t) për qëllimet e Aktivitetit;
- f) kostot që rrjedhin drejtpërdrejt nga kërkesat e Kontratës (shpërndarja e informacionit, vlerësimi specifik për Aktivitetin, kontabiliteti, auditimet, përkthimi, riprodhimi, sigurimi, etj.).

### **Kostot/kostot e pa kualifikueshme që ne NUK do t'i mbështesim**

- tatimet, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) - (pa përfshirë tatimin në paga);
- detyrimet doganore dhe të importit, ose ndonjë tarifë tjetër;
- blerja, marrja me qira ose dhënia me qira e tokës dhe objekteve ekzistuese;
- gjambat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;
- kostot indirekte të operimit, kostot e garancive dhe tarifën e ngjashme;
- kostot e konvertimit, tarifën dhe humbjet nga këmbimi me ndonjë nga llogaritë në euro specifike për komponentin, si dhe shpenzimet e thjeshta financiare;
- kontributet në natyrë;
- kostot e amortizimit;
- borxhet dhe ngarkesat e borxhit;
- provizionet për humbjet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;
- interesi i mbetur borxh;
- kostot e deklaruara nga përfituesi, dhe të mbuluara nga një aktivitet ose program tjetër pune;



- kreditë për palët e treta.

## 5. Procedurat e Aplikimit

Paketa e Aplikimit duhet të dorëzohet përmes e-mail, dhe duhet të përfshijë tri dokumentet e mëposhtme:

1. **Formularin e aplikimit**
2. **Formularin e buxhetit**
3. **Aktin e regjistrimit** nga autoriteti publik përkatës

**Aplikimet DUHET të dërgohen përmes e-mail, në adresën elektronike: [grants@advocacy-center.org](mailto:grants@advocacy-center.org), jo më vonë se deri më 21 nëntor 2022, ora 16:00.**

Aplikimet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

## 6. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve

Aplikacionet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktues (ATRC) me ndihmën e vlerësuesve të jashtëm.

Nëse shqyrtimi i Aplikacionit tregon se aktiviteti i propozuar nuk i plotëson kriteret e kualifikueshmërisë, Aplikacioni refuzohet vetëm mbi këtë bazë.

Të gjitha aplikacionet do të vlerësohen duke ndjekur kriteret e mëposhtme:

	<b>Kriteret</b>	<b>Përkufizimi</b>	<b>Koeficienti maksimal</b>
1.	Relevanca e veprimit me prioritetet e Thirrjes për Propozime	Ky kriter vlerëson relevancën e përmbajtjes së veprimit, kundrejt objektivave të Thirrjes për Propozime të projektit. Komisioni vlerësues do të shqyrtojë ndikimin e propozimeve në grupet e përzgjedhura të shënjestruara dhe përfituesit e projektit.	40
2.	Dizajni i veprimit	Ky kriter vlerëson ndikimin e përgjithshëm të koherencës së propozimit të përgjithshëm të veprimit, analizës së problemit, rezultateve të	20



		prishme, temave/aktiviteteve të reja dhe inovative që nuk janë analizuar/zbatuar më parë nga sindikatat, OSHC-të, shoqatat e avokatëve dhe mediat në Kosovë.	
3.	Efektiviteti dhe fizibiliteti i veprimit	Ky kriter vlerëson aktivitetet e propozuara të projektit duke vlerësuar nëse ato janë të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritura.	10
4.	Buxheti dhe efektiviteti i kostos	Ky kriter vlerëson buxhetin dhe bilancin ndërmjet kostove të vlerësuara të veprimit të propozuar dhe kostove reale në përputhje me çmimet aktuale të tregut.	20
5.	Qëndrueshmëria e veprimit	Ky kriter vlerëson praktikën, ku nevojat dhe veprimet njerëzore trajtohen në mënyrën që është miqësore ndaj mjedisit dhe e qëndrueshme, tregon ndikimin e prekshëm në grupet e shënjestruara të propozimit, si dhe përfshin efektet shumëfishuese të implementimit të veprimit.	10
<b>PIKËT E PËRGJITHSHME</b>			<b>100</b>

## 7. Njoftimi i Autoritetit Kontraktues

Secili aplikant do të informohet me shkrim për vendimin, së bashku me një arsyetim lidhur me vendimin, sipas vlerësimit të jurisë.

### 7.1 Përmbajtja e vendimit

Shkresat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm do të dërgohen brenda 5 ditëve të punës, pas përzgjedhjes, deri më datë 6 dhjetor 2022. Aplikantët e pasuksesshëm do të kenë të drejtën për të kërkuar sqarime shtesë brenda 10 ditëve të punës nga data e njoftimit.





Funded by  
the European Union

## 7.2 Plani kohor indikativ

	DATA	KOHA
Shpallja publike e Thirrjes për Propozime	31 tetor 2022	10:00
Afati i fundit për të kërkuar sqarime nga ATRC/BIRN Kosova	09 nëntor 2022	16:00
Data e fundit në të cilën janë dhënë sqarimet nga ATRC/BIRN Kosova	11 nëntor 2022	N/A
Afati i fundit për dorëzimin e Paketës së Aplikimit	21 nëntor 2022	16:00
Afati i fundit për vlerësimin e propozimeve të pranuar	30 nëntor 2022	
Informimi i aplikantëve mbi vlerësimin e formularit të aplikimit	nga 01-06 dhjetor 2022	
Nënshkrimi i kontratave	deri më 26-27 dhjetor 2022	
Data e fillimit të projekteve	1 janar 2023	

\*Ju lutemi vini re që ky është vetëm një plan kohor indikativ, datat e sakta aktualisht nuk janë të disponueshme.

Pyetjet lidhur me propozimet e Thirrjes për Propozime mund të dërgohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze përmes e-mail, para datës 09 nëntor 2022, në adresën elektronike: [grants@advocacy-center.org](mailto:grants@advocacy-center.org).

Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet, si dhe njoftimet e tjera të rëndësishme për aplikantët do të publikohen në faqen zyrtare të ATRC-së, jo më vonë se 7 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve.

## 7.3 Sesionet informuese

Sesioni informues për këtë Thirrje për Propozime do të mbahet drejtpërdrejt. Ju lutemi kontrolloni faqen e internetit të ATRC-së dhe faqet e mediave sociale për orarin e saktë të sesionit informues.







Funded by  
the European Union

Sesionet informuese do të mbahen më 8 nëntor 2022, ora 10:00, në Europe House në Mitrovicën e Veriut, dhe më 9 nëntor 2022, ora 10:00, në Europe House në Prishtinë.

